**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
**Komuna e Drenasit**
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqënje Sociale
**06-Nr.**020/04-30072 **dt.**16/06/**2024**

Në Vështrim të nenit 49 të Ligjit për procedurën e përgjithshme Administrative,nenit 16 paragrafi 3,të Rregullorës MF-NR, 04/2017 mbi Kriteret,Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve,Rregulloes Nr.12/320-19338,të dates, 07.04.2017 për kushtet,kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve,dhe rregullores për plotësim ndryshim me nr 02-400/01-18380 të datës 27.04.2022,bazuar në Vendimin 01-Nr.400/01/27156 të datës 06/06/2024,të Komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërksave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06 Nr.400/01-26133, të dt.03.06.2024,të shpallur nga Drejtoria për Shendëtsi dhe Mirëqenje Sociale për vitin 2024 pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentave aplikuese të OJQ-ve,Komisioni merr ketë:

# V E N D I M

I.Përcaktohet aplikanti I kualifikuar për mbështetje finaciare Shoqata e Përsonave me Aftësi të Kufizuara"HANDIKOS",

II.Vlera e përkrahjës financiare në bazë të thirrjës publike është **5000€,**Financimi I subvecionimit të projektit do të behet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere /kodi ekonomik 21/611/73010/2100/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2024 të Drejtorisë për Shendëtsi dhe Mirëqenje Sociale,

III.Ky Vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga Kuvendi Komunal I Drenasit dhe vlerësimi I ligjshmerisë nga ana e MAPL-së.

**KËSHILLA JURIDIKE:**
Për pakënaqësit eventuale ndaj këtij vendimi,mund të ushtrohet ankesë pran Komisionit të Ankesave,Brenda afatit prej pesë(5)ditësh nga dita e publikimit.

Anëtarët e Komisionit:
1.Arlinda Kukaj (DSHMS)______
2.Kajtaz Kastrati (DK)______
3.Afrim Gllareva (DA)______
4.Mehdi Ademi (Shoqëri Civile)______
5.Kadire Tahiraj (OJQ)______
6.Jeton Prokshi QPS-anëtarë reserve______

Vendimi I Dërgohet:
•Zyrës së Kryetarit,
•Anëtarve të Komisionit
•Arkivit dhe
•DSHMS-së

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY
PRANUAR 26/06/2024
Nj. Org. Numër Shtojca Vlera
06-020/04-30072

*Republika e Kosovës*
*Republika Kosova-Republic of Kosovo*
*Qeveria - Vlada - Government*
*Komuna e Drenasit*
*Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale*

Në bazë të Nenit 8, parag. 6, të Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Vendimit Nr. 01-400/01-1756 dt.06.06.2024 për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Aplikacioneve të OJQ-ve për financim të projekteve/programeve të paraqituara në thirrjen publike "Për Ofrimin e mbështejtjes financiare të interesit publik për financimin e projketeve/programeve të OJQ-ve dhe përsonave fizik pë fushën e Mirëqenies e përkujdesjes sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale e familjare të kategorive me kërkesa të veçanta.

**RREGULLAT E PUNËS**

Të komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve Për Ofrimin e mbështejtjes financiare të interesit publik për financimin e projketeve/programeve të OJQ-ve dhe përsonave fizikë për fushën e Mirëqenies e përkujdesjes sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale e familjare të kategorive me kërkesa të veçanta.

**Neni 1**

**Qëllimi i miratimit të rreguliave**

1. Rregullat e punës të komisionit për vlcrësimin e aplikacioncve të OJQ-ve për ofrimin e mbështetjcs fmanciare publike për ftnancim të projekteve programeve sipas thirrjes publike do të rregullojë mënyrën e kryeijcs së dctyravc, të drcjtave dhc obligimct c anëtarëvc të Komisionit, vendimmanjen dhc çështjc të tjera në kuadër të kompetcncavc të komisionit.

2. Komisioni do të punojë duke u bazuar në Rregullat në fuqi, në veqanti në bazë të rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedural e Fnancimit publik të OJQ-ve.

## Neni 2

### Kompetencat e komisionit

1. Komisioni ka për dëtyrë të vlerësoj çdo aplikim nëse i plotëson ose jo kushtet e përgjithshme proceduralc të përcaktuara me thinjen publikc dhc rrcgullorcn mbi kriteret,standardct dhc proccdurat\e financimit publik të OJQ-ve

2. Komisioni do të përgatis një raport për të gjitha aplikacionet e shqyrtuara nga komisioni duke i listuar të gjitha aplikacionet dhe duke treguar nëse i plotësojnë ose jo kushtet kushtet e thirrjes publike.

3. Në fazën e dytë të vlerësimit, komisioni do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes të të gjitha aplikimeve në kuadër të thirrjes publike të cilat i plotësojnë kriteret formale për vlerësim përmbajtësor.

4. Komisioni vendos për ndarjen e detyrave brenda komisonit, dhe përcakton nëse secili nga anëtarët do të vlerësojnë secilin aplikacion apo do të bëhet ndarja e përgjegjësisve.

5. Edhe në rastet kur brenda komisionit ndahen detyrat, përgjegjësia e komisionit dhe vendimmarrja është kolektive.

6. Komisioni do të sigurojë që secili nga anëtarët të ketë ndarje dhe ngarkesë proporcionale me detyra në kuadër të komisionit.

7. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e komisionit paraqct ndonjë konflikt intcresi, atëherë komisioni duhet të shqyrtoj rastin e tillë dhe ti kërkojë udhëheqësit të institucionit zëvendësimin e tij. Në këto raste, deri në zëvcndësimin e anëtarit në konflikt interesi, anëtari rezervë do ta zëvendësoj atë.

**Neni 3**

**Detyrat e anëtarëve të komisionit**

1. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë aplikacionct në aspektin proccdural si në vijim:

   1.1. Të hapin çdo aplikim të paraqitur në kuadër të thinrrjes publike dhe të bëjnë regjistrimin përkatës të aplikacionit, dukc përfshirë cdhc vendosjen e numrave referues.

   1.2. Të analizojnë të gjithë dokumentacionin e paraqitur.

   1.3. Përcaktojnë nëse aplikimet i kanë përmbushur kushtet e konkursit, duke përfshirë cdhe përdorimin e formave të standardizuara dhe plotësimin e tyre nga ana e aplikuesve.

   1.4. Të përcaktojnë nëse aplikantët i kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara përmes thirrjes publike.

   1.5. Nëse është e nevojshme të kërkojnë nga aplikantët për të siguruar informacion/dokumcntacion shtesë por që nuk ndikon në përmbajtjen e aplikacionit, si dhe kontrollimin dhe verifikimin e këtij informacioni/dokumentacioni shtesë.

   1.6. Të hartojnë dhe të nënshkruajnë procesverbalin e takimit duke përcaktuar nëse secili prej aplikimeve në mënyrë individuale i plotëson ose jo kushtet e thirrjes publike, mbi bazën e të cilit pastaj Institucioni përkatës do të përgatisë një njoftim me shkrim për aplikantët.

2. Secili nga anëtarët e komisionit do të kenë për detyrë të vlerësojnë përmbajtjen e aplikacioneve si n vijim:

2.1. Të informohet me tekstin e thirrjes publike dhe të nënshkruajnë një deklaratë të paanësisë dhe konfidencialitetit.
2.2. Të shqyrtojë dhe vlerësojë përmbajtjen e projekteve dhe programeve të OJQ-vc aplikuese të cilat i kanë plotësuar kriteret procedurale. Vlerësimi duhct të bëhet sipas pyetjeve dhe formave të parapara me rregullativën juridike në fiiqi.
2.3. Të bëjë vlerësim të paanshëm, objektiv dhe pa ndikim nga subjekte tjera, duke shpjeguar me shkrim vlerësimin e tij, dhc duke iu referuar në shpjegimet e tij dokumentacionit të OJQ-së aplikuese, madje edhe duke citauar atë, dhe duke treguar pse pikërisht ka bërë atë (vlerësim).
2.4. Të vlerësoj koston e projektit për të formuar buxhetin e nevojshëm për impementimin e tij.
2.5. Të identifikojë dhe vlerësoj përparësitë dhe mangësitë e çdo aplikacioni të vlerësuar.
2.6. Të rekomandoj sigurimin e dokumentacionit shtesë nëse e sheh të nevojshme.

**Neni 4**

**Përbërja e komisionit dhc detyrat e anëtarëve**

1. Komisioni për vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare publike të projektevc/programeve sipas thirrjcs publike për mbështetje financiare të OJQ-vc për "Ofrimin e mbështejtjes financiare të interesit publik për financimin e projketeve/programeve të OJQ-ve dhe përsonave fizik për fushën e Mirëqenies e përkujdesjes sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale e familjare të kategorive me kërkesatë veçanta, ka anëtarë dhc Kryesues të Komisionit.

2. Kryesuesi e koordinon punën e Komisionit, duke përfshirë edhe koordinimin e qëndrimeve përpërgatitjcn e raportit përfundimtar të Komisionit vlerësues.
3. Në rastë të dorëheqjes së ndonjërit nga anëtarët e komisionit vlerësues, vendimin për aprovimin e dorëheqjes së tij e merr zyrtari kyryesor administrativ i cili ka themeluarkomisionin. Deri në aprovimin formal të dorëhcqjes, anëtarët janë të detyruar të marrin pjcsë në punën c rregullt të komisionit, përveç rasteve të konfliktit të interesit.
4. Në rast të dorëhcqjes të ndonjërit nga anëtarët e komisionit, kryesuesi do të ftoj anëtarin rczervë për të marrë pjesë në vlerësim.

**Ncni 5**

**Shmangia e konfliktit të interesit dhc mbajtja e konfidencialitetit**

1. Çdo anëtar i Komisionit vlerësues është i detyruar që në fillim të nënshkruajnë një deklaratë të paanësisë dhe konfidencialitetit. Me nënshkrimin e Deklaratës, anëtarët e Komisionit konfirmojnë se detyrat e tyre në komision do trajtohen në mirëbesim, në mënyrë të paanshmedhe të pavarur, në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me parimin e shmangies së konfliktit të interesave.Po ashtu, ata pranojnë se do të trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha a aplikacionet, duke i vlcrësuar në përputhje mc rrcgullat më fuqi.
2. Secili anëtarë i komisionit që ka informacion se ndonjëri nga anëtarët mund të ketë konflikt interesi,duhet që ta informojë komisionin menjëherë.
3. Anëtarët e komisionit vlerësues gjatë dhe pas përfundimit të punës së komisionit nuk kanë të drejtë të nxjerrin informacion në publik apo të informojnë ndonjërin prej aplikantëve mbi përmbajtjen e diskutimeve dhe vendimeve të marra përkitazi me aplikimet individuale, dhe nuk guxojnë të asnjë lloj informacioni i cili është i karakterit të brendshëm.

Emrat e anëtarëve të komisionit do të bëhen publik vetëm kur të publikohen rezultatet e thirrjes.

**Neni 6**

**Mbështctja tcknikc pcr komisionin vlcrcsucs**

Përkrahja administrative dhe teknike për të gjitha aktivitetet e komisionit që ndërlidhen me thirrjen publike duhet të sigurohet nga institucioni/njësia që ka hapur thirrjen publike.

**Neni 7 Hyrja në fuqi**

Rrcgullat e punës së komisionit vlerësues janë miratuar në takimin/seancën e mbajtur më: 21.06.2024

Anëtarët e komisionit

1. *Arlinda Kukaj DSHMS*
2. *Kajtaz Kastrati DK*
3. *Afrim Gllareva, DA*
4. *Mehdi Ademi, Shoqëri Civile*
5. *Kadire Tahirja, OJQ*
6. *Jeton Prokshi, QPS- (anëtarë rezervë)*

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Komuna e Gllogocit**
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

06 **Nr** 020/04-20072 **dt.** 26/06/**2024**

**PROCESVERBAL**
**nga**
**Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-26133, të dt.03.06.2024 , nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale për vitin 2024**

Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve për OJQ përmes thirrjes publike Nr.400/01-26133, të dt. 03.06.2024, Vendimit për Shpallje të Thirrjes Publike nr 01-400/01-27156 dt.03.06.2024 vendimit për Themelimin e Komisionit Vlerësues me nr.01-400/01-27156 date 06.06.2024 nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale për vitin 2024, përkatësishtë subvencionimin e OJQ-ve, ka mbajtur takime pune për shqyrtimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve, duke filluar me takimin e parë dt. 21.06.2024, nga ora 10:00 në mbledhjen për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve të OJQ-ve, lidhur me ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për fushën e Mirëqenjes dhe përkujdesjes sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare të kategorive me kërkesa të vecanta. e gjithë kjo bazuar në Rregulloren MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe Procedurat e Financimit publik të OJQ-ve.
Në takimin e parë janë të pranishëm komisioni: Arlinda Kukaj -DSHMS, Kajtaz Kastrati-DKRS, Afrim Gllareva DKA, Mehdi Ademi – Shoqëri Civile, Kadire Tahiraj të cilët fillimisht miratojnë edhe Rregullat e punës si nënshkruajnë deklaratën nën betim.

Mbledhja hapet nga përfaqësuesi i DSHMS-së (kryesuesi i komisionit). Gjithsej kishim gjashtë (6) aplikacione OJQ:" të cilat kishin aplikuar për subvencionim me zarfe të mbyllura.

1. Komisioni vazhdoi punën me hapjen e zarfit të parë **Organizata 'Liderët e së Ardhmes'** me nr të protokolit 06-070/01-29276 të datës 20.06.2024, pas hapjes së zarfit Komisioni vlerësues shqyrtoi e gjithë dokumentacionin ofrues nga aplikuesi dhe dokumentacioni i paraqitur nuk i plotëson kriteret sipas thirrjes pubike.(dokumentacion i pakompletuar)

2.Zarfi i dytë i hapur poashtu me shumë transparencë nga komisioni vlerësues "**Shoqata Komunale e pensionistëve të punës Komoran**" me nr të protokolit 06-070/01-29246 të datës 20.06.2024 Nuk e ka të plotësuar dokumentacionin e ofruar Projekti financiar i pa plotësuar gjithashtu i njejti nuk ka aktivitete të zhvilluara për një vit,nuk i plotëson kriteret sipas thirrjes publike.(dokumentacioni i pakompletuar)

3.Zarfi i tretë i hapurt nga komisioni si Individ **Leon Balaj**, me nr 06-070/01-29193 të datës 20.06.2024 komisioni pas analizoj në detaje dokumentacionin e ofruar konstatoj se nuk i plotëson kriteret sipas thirrjes publike (dokumentacioni i pakompletuar).

4.Zarfi i katërt me radhë si ndiviid **Vlersim Istogu**-me nr 06-070/01-29007 të datës 19.06.2024 nuk i plotëson kriteret sipas thirrjes publike( dokumentacioni i pakompletuar).

5.Zarfi me numër pesë si individ.**Doruntina Zogu** me nr 06-070/01-28874 të datës 18.06.2024 – Nuk i plotëson kriteret sipas thirrjes publik-(dokumentacioni i pakompletuar)

6.Zarfi i fundit i hapur nga komisioni .**Handikos me** nr 06-400/01-27938 të datës 11.06.2024-I përmbush të gjitha kushtet dhe kriteret sipas thirrjes publike,të gjithë dokumentacionin e ka të plotësuar dhe të kompletuar.

Në këtë mbledhje diskutohet lidhur me formularët dhe gjithë dokumentacionin e kërkuar në bazë të thirrjes si dhe procedurën e shqyrtimit si dhe vlerësimin e apliacioneve në bazë të kritereve të kërkuara.

**<u>Pas verifikimit të dokumentacionit të prezantuar nga ana e OJQ-ve, ishin:</u>**

| ORGANIZATAT QË KANË APLIKUAR PËR SUBVENCIONE DHE DOKUMENTET E PARAQITURA |
|---|
| **1. OJQ-liderët e së ardhmes** |
| 1. Aplikacioni për projekt (F1)<br>2. Formulari për aplikim<br>3. Letërnjoftimi<br>4. CV<br>5. Qertifikate e regjistrimit si OJQ<br>6. Deklarata e Financimit të dyfisht(F3) |

| |
|---|
| 7. Deklaratë mbi projektet nga burimet e financimit te vitit 2024((F5)<br>8. Forma e buxhetit të thirrjes(formulari 10)<br>***Vërejtje:sipas vlerësimit të Komisionit OJQ në fjalë nuk i plotëson kriteret e parapara sipas thirrjes publike.*** |
| 2 **.Shoqata e pensionistëve të punës** |
| 1. Aplikacioni për projekt(F1)<br>2. Aplikacioni për projekt/program (pa plotësuar)<br>3. Forma e buxhetit të thirrjes formulari 10 (nuk e ka paraqit në dokumentacion)<br>4. Kosto e pagave per punonjesit(e paplotesuar)<br>5. Deklaratë mbi projektin e financimit per 2024(e paplotesuar)<br>6.Konfirmimi i llogarisë<br>7. Formulari(F7)(i paplotësuar)<br>8. Raporti Financiar(i paplotësuar)<br>9. Formulari (F2) i paplotësuar<br>10.Formulari (F3) I paplotesuar<br>11. Pasqyra tremujore e tatimit<br>12. Kërkese drejtuar dshms-së<br>13.Qertifikate e rexhistrimit si OJQ<br>14.Letërkonfirmim nga ministria e puneve të brendshme<br>***Vërejtje:sipas vlerësimit të Komisionit OJQ në fjalë nuk i plotëson kriteret e parapara sipas thirrjes publike.*** |
| **3.Leon Balaj-si Individ** |
| 1.Aplikacioni për projekt program<br>2. Forma e buxhetit të thirrjes formulari 10<br>3. Deklaratë mbi aktivitetet e pershkruara te programit/projektit formulari 14(F6)<br>4. Cv<br>***Vërejtje:sipas vlerësimit të Komisionit OJQ në fjalë nuk i plotëson kriteret e parapara sipas thirrjes publike.*** |
| **4. Vlersim Istogu-si individ** |

| |
|---|
| 1.Formulari 10 forma e buxhetit<br>2.Deklaratë për financim të dyfishtë (F3)<br>3.Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike per 2024 (F5)<br>4.Aplikacioni për projekt/program<br>5.Cv<br>6.Letërnjoftimi<br>7. llogaria bankare<br>8.Cd<br>***Vërejtje:sipas vlerësimit të Komisionit OJQ në fjalë nuk i plotëson kriteret e parapara sipas thirrjes publike.*** |
| 5.**Doruntina Zogu-Si individ** |
| 1.Formulari 10 forma e buxhetit te thirrjes<br>2.deklarata për financim të dyfishtë (F3)<br>3.Aplikacioni për projekt program<br>4.Deklaratë mbi projektet e financuara formulari 13<br>5.CV<br>6.Cd<br>***Vërejtje:sipas vlerësimit të Komisionit OJQ në fjalë nuk i plotëson kriteret e parapara sipas thirrjes publike.*** |
| **6.Handikos-OJQ** |
| 1.Aplikacioni për projekt (F1)<br>2. Forma e buxhetit të thirrjes (F2)<br>3.Deklaratë mbi aktivitetet e pershkruara (F6)<br>4.Deklaratë mbi projektet e financuara për 2024 formulari 13<br>5.Deklarata për financim të dyfishtë(F3)<br>6.Deklarata e partneritetit (F4)<br>7.Çertifikata e rexhistrimit si OJQ<br>8.Çertifikata e numrit fiskal<br>9.Çertifikata e licencimit<br>10.Vërtetimi i llogarisë bankar |

11.Vërtetimi tatimor

12.letërkonfirmimi si organizate joqeveritare leshuar nga ministria e administrates publike-vërtetim nga administrata tatimore OJQ

13.Letërnjoftimi

***Sipas vlerësimit të Komisionit OJQ Handikos i plotëson Të gjitha kriteret e parapara sipas thirrjes publike.***

Sipas nenit 16 paragrafi 1.3 komisioni është siguruar që projektet/programet e përzgjedhura për mbështetje financiare i plotësojnë të gjitha kriteret e thirrjes publike të lartëcekur, dhe i kontribojnë arritjes së prioriteteve dhe objektivave të thirrjes, si dhe kriteret e proceduarale dhe përmbajtësore të përcaktuara në Rregulloren MF-NR-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, duke u fokusuar në përputhshmërinë e programit dhe fushat prioritare të thirrjes.

Komisioni Vlerësues pas perfundimit të procesit të vlerësimit nxjerr vendim në të cilin përcaktohen aplikantet e kualifikuar për mbështetje financiare (neni 16 pika 3).

**Sqarim:** *Të gjitha aplikacionet janë vlerësuar me argumente dhe në mungesë të dokumentacionit dhe asnjëra nga këto OJQ të refuzuar nuk kanë dëshmi se gjatë 1 viti janë marrë me organizimin e ngjarjeve –shërbimeve sociale , shërbime rehabilituese,përvec OJQ Handikos i cili kontribuon arritjes së prioriteteve dhe objektivat e thirrjes:*

**Komisioni:**

1. *Arlinda Kukaj, DSHMS*
2. *Kajtaz Kastrati, DKRS*
3. *Afrim Gllareva, DKA*
4. *Mehdi Ademi, Shoqëri Civile*
5. *Kadire Tahiraj, OJQ*
6. *Jeton Prokshi, QPS- (anëtarë rezervë)*